

## **INFORMATË LIDHUR ME NDYSHIMET E LIGJIT TË SHETËSISË**

Që nga **1 janari 2018** hynë në fuqi rregulla të reja mbi kushtet për fitimin e shtetësisë zvicerane. Kështu që ligji aktual federal mbi shtetësinë do të pësoi disa ndryshime të rëndësishme. Risitë më kryesore janë këto si vijojnë :

- Sa i përket statusit të qëndrimit, kandidati që bënë kërkesë duhet të posedojë **së paku lejen C të qëndrimit C** (rregulla e tanishme lejon edhe ate B e disa leje të tjera) ;
- Kushti i kohëzgjatjes së qëndrimit në Zvicër do të **zbritet në 10 vite** (në krahasim të 12 viteve që kërkohej aktualisht). Koha e kaluar në Zvicër në mes të moshës 8 dhe 18 vjeçare do të llogaritet dyfish.

Edhe dy çështje të tjera :

- Për personat të cilat kanë depozuar një kërkesë para datës 1 janar 2018, ndryshimi i tillë nuk do të ketë asnjë pasojë, pasi që procedura e hapur e shqyrtimit të kërkeses së shtetësisë do të zhvillohet edhe më tutje sipas rregullave të ligjit aktual. **Nuk aplikohet pra parimi i retroaktivitetit** për rregullën përkatëse ;
- Disa nga kushtet tjera federale për fitimin e shtetësisë nuk kanë me pësuar ndonjë ndryshim të madhë, në përjashtim të disa kantoneve posaçërisht të Zvicrës qendrore që parashikojnë një **ashpërsim të më tutjeshëm të disa kushteve kantonale** për shtetësinë.

Ndryshimet e parashikuara vlejnë për rregullat e fitimi të shtetësisë përmes procedurës ordinare. Edhe rregullat për shtetësinë përmes procedurës së lehtësuar do të pësojnë disa ndryshime.

Zyra për këshilla juridike « Begzati »  
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel  
Kontakti. 079/354'67'13  
[www.zyra-begzati.ch](http://www.zyra-begzati.ch)